

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaGrout® HT System

GRAUT ME BAZË ÇIMENTOJE DHE ME 2 PËRBËRËS PËR APLIKIME ME DERDHJE NË TRASHËSI TË MADHE (HIGH THICKNESS, HT) ANKORIMI, GRAUTING ME PRECIZION TË LARTË DHE MBUSHJE TË PLLAKAVE TË BAZAMENTEVE.

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaGrout® HT System është llaç me bazë çimentoje me 2 përbërës, rrjedhje të lirë dhe tkurrje të kompensuar që aplikohet me derdhje për punime në trashësi të mëdha si ankorimet, grauting me precizion të lartë dhe mbushje të pllakave të bazamenteve, që plotëson kërkesat e EN 1504-6.

PËRDORIMET

SikaGrout® HT System-80 përdoret si llaç që aplikohet me derdhje, ka tkurrje të kompensuar dhe rrjedhje të lirë për trashësi shtrese midis 15 mm dhe 80 mm. SikaGrout® HT System-120 përdoret si llaç që aplikohet me derdhje precize, ka rrjedhje të lirë dhe kompensim të jashtëzakonshëm të tkurrjes për trashësi shtrese midis 15 mm dhe 120 mm.

Të përshtatshme për:

- Grauting preciz midis themeleve dhe suportesve, poshtë pllakave të bazamenteve, izoluesve sizmikë apo makinerive të rënda dhe pajisjeve
- Aplikime ankorimi si bulona (ankorazhe, vida, etj.) dhe struktura metalike për bllaqet e pllakave mbështetëse, makineri, shtylla themelesh, etj.
- Mbushje me derdhje të thjeshtë (ose pompim) i zgavrave, plasaritjeve dhe hapësirave në beton, mure, shkëmbinj, etj.
- Fugat e lidhjes në pjesë betoni të parafabrikuar
- Restaurim betoni me derdhje llaçi brenda betoformave (trarë, kolona, kuverta urash)
- Fiksime
- Përforcim strukturor (Parimi 4, metoda 4.2, EN 1504-9). Instalim shufrash në bira të shpuara ose të paraformuara tek betoni.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përdorim i lehtë, gati për përzjerje, thjesht shtoni ujë
- Kompensim i jashtëzakonshëm i tkurrjes (në fazë plastike dhe të ngurtësuar)
- Vetë të shkëlqyera rrjedhjeje, punueshmërie dhe qëndrueshmërie
- Pa segregim dhe rrjedhje
- Rezistenca mekanike të larta dhe ngjitje e shkëlqyer mbi beton dhe çelik
- Mund të derdhet dhe/ose pompohet
- Për trashësi të madhe aplikimi deri në 120 mm në një shtresë
- Në përputhje me standardin EN 1504-6 si produkt ankorimi
- Klasifikimi i zjarrit A1

MIRATIME / STANDARDE

Markë CE dhe deklaratë performance si produkt ankorimi për përforcimin e betonit duke instaluar çelik përforcues (shufra) në ndërtesa dhe vepra të inxhinierisë së ndërtimit sipas EN 1504-6:2006, Parimi 4, Metoda 4.2 sipas EN 1504-9:2008, bazuar në certifikatën e organit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe llojin e testimit.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Përbërësi A (SikaGrout®-212 Classic ose SikaGrout®-312 HP): Çimento Portland, agregate të përzgjedhura dhe aditivë të posaçëm Përbërësi B (SikaGrout® Quartz Sand): Agregate të përzgjedhura, të rrumbullakosura, me granulometri të mirë dhe pa lëndë mbushëse (filler) - me bazë oksidi silici (SiO ₂) >99%		
Ambalazhi	SikaGrout® HT System-80: set 31.25 kg (A+B) SikaGrout® HT System-120: set 31.25 kg (A+B)		
		SikaGrout® HT System-80	SikaGrout® HT System-120
	Përbërësi A (thes 25 kg)	SikaGrout®-212 Classic	SikaGrout®-312 HP
	Përbërësi B (thes 6.25 kg)	SikaGrout® Quartz Sand	SikaGrout® Quartz Sand
Paraqitja / Ngjyra	Përbërësi A: Pluhur gri Përbërësi B: Agregate		
Jetëgjatësia	Përbërësi A: 12 muaj nga data e prodhimit Përbërësi B: E pakufizuar		
Kushtet e magazinimit	Përbërësi A: Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur, të vulosur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe në temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor. Përbërësi B: Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur, të vulosur dhe të padëmtuar në kushte të thata.		
Dendësia	~ 2.25 kg/l (dendësia e llaçit të freskët)		EN 1015-6
Përmasa maksimale e kokrrizës	~ 5.0 mm		
Përmbajtja në jone të tretshme kloruri	≤ 0.05%		(EN 1015-17)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes		1 ditë	7 ditë	28 ditë	(EN 12190)
	SikaGrout® HT System-80	≥ 28 N/mm ²	≥ 50 N/mm ²	≥ 75 N/mm ²	
	SikaGrout® HT System-120	≥ 30 N/mm ²	≥ 55 N/mm ²	≥ 70 N/mm ²	
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje		1 ditë	7 ditë	28 ditë	(EN 196-1)
		≥ 5 N/mm ²	≥ 7 N/mm ²	≥ 9 N/mm ²	
Rezistenca ndaj shqitjes	≤ 0.6 mm në ngarkesë 75 kN				(EN 1881)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 2.0 MPa				(EN 1542)
Reagimi ndaj zjarrit	EuroClass A1				
Absorbueshmëria kapilare	≤ 0.5 kg m ⁻² h ^{-0.5}				(EN 13057)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes		Sasia e ujit
	SikaGrout® HT System-80 (A+B)	3.5 - 4.0 lt për set
	SikaGrout® HT System-120 (A+B)	3.6 - 3.9 lt për set
Konsumimi	~ 2.0 kg SikaGrout® HT System për 1 mm trashësi për m ² , në varësi të ashpërsisë së nënshtresës dhe dendësisë së llaçit të freskët.	
Rendimenti	31.25 kg e HT System (A+B) prodhon afërsisht 15.6 litra llaç	

Trashësia e shtresës	SikaGrout® HT System-80	min. 15 mm - max. 80 mm	
	SikaGrout® HT System-120	min. 15 mm - max. 120 mm	
Aftësia për rrjedhje	SikaGrout® HT System-80	210-260mm	EN 13395-1 (metodë e modifikuar)
	SikaGrout® HT System-120	200-250mm	
	SikaGrout® HT System-80	70-80 cm	EN 12350-2 me konin Abrahms
	SikaGrout® HT System-120	70-80 cm	
Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +35°C max.		
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.		
Koha e punueshmërisë	~30 minuta (në +20°C)		

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Beton:

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër dhe pa pluhur, papastëri dhe materiale të lira, kontaminues sipërfaqësorë si vaj apo graso, kore çimentoje, të cilat mund të reduktojnë lidhjen, parandalojnë thithjen apo dëmtojnë rrjedhjen e grautit. Betoni i shpëtëzuar, i dobët dhe i shkatërruar dhe kudo nevojitet edhe betoni i shëndetshëm - por jo deri në dëmtin të integritetit strukturor - duhet të hiqet me teknika të përshtatshme përgatitjeje mekanike, si pastrimi me ujë me presion të lartë ose me fryrje me rrymë rëre. Preferohen metoda pastrimi pa vibrim. Ashpëroni sipërfaqen prej betoni për të ekspozuar agregatet deri në 2 mm thellësi, në përputhje me EN 1766 ose CSP 5 nga Udhëzimet ICRI. Skajet e zonës së ndikuar nga ndërhyrja duhet të priten në mënyrë përpindikulare (90 gradë) në thellësi deri në 5 mm. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes (shqitjes) duhet të jetë >1.5 MPa. Ndiqni udhëzimet që jepen nga supervizori ose nga inxhinierë të kualifikuar. Në rastet e pllakave të bazamenteve, sipërfaqet prej betoni duhet të jenë në përgjithësi të niveluara (brenda tolerancave) dhe të mos vendosen në pjerrësi, në mënyrë që grauti të rrjedhë deri në pikën më të fundit.

Çelik:

Sipërfaqja e armaturës prej çeliku si edhe pjesët e tjera prej çeliku (si pllakat metalike dhe/ose bulonat metalikë në punimet e vendosjes së pllakave të bazamenteve) nuk duhet të kenë ndryshk, llaç, mbetje betoni, vaj, graso dhe çdo lloj materiali tjetër i cili mund të reduktojë lidhjen ose të shkaktojë korrodim. Në rast ndryshku, pastroni në mënyrë të njëtrajtshme të gjithë perimetrin e shufrave të çelikut (ku është e aplikueshme) duke përdorur teknika pastrimi me fryrje abrazive ose me ujë me presion të lartë deri në Sa 2 në përputhje me ISO 8501. Mbroni shufrat e pastruara nga kontaminimi i mëtejshëm, përpara aplikimit të llaçit.

Betoformë:

Çdo betoformë duhet të ketë kapacitetin e bartjes së ngarkesës dhe forcave që i ushtrohen. Betoforma

duhet të jetë e pastër dhe e vendosur në pozicion pas përgatitjes së nënshtresës dhe armaturës. Disarmantët si seria Sika® Separol®, duhet të aplikohen përpara vendosjes së shufrave në pozicion për të shmangur kontaktin me nënshtresën e përgatitur. Betoforma duhet të jetë dizenuar saktë për të lejuar rrjedhjen e ajrit dhe ujit, të mbështesë teknikën e rrjedhjes, të ofrojë mbushjen e plotë, të parandalojë rrjedhjen e produktit, etj.

Ju lutemi këshillohuni me shërbimin teknik të Sika Albania SHPK për udhëzime më specifike. Referohuni gjithashtu tek EN1504-10 për kërkesa të veçanta.

PËRZIERJA

SikaGrout® HT System mund të përzihet me një përzierës elektrik manual në shpejtësi të ulët (~500 r.p.m.) me akse vertikale për 1 deri 2 thasë duke u kujdesur për të mos bllokuar ajrin brenda miksit, ose duke përdorur një përzierëse me kovë të madhe për 2 deri në 3 thasë - ose më tepër - njëherësh, në varësi të llojit dhe përmasës së përzierësit. Hidhni ujë në raportin e saktë të dëshiruar brenda një kontenieri të përshtatshëm për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni Përbërësin A (SikaGrout®-212 Classic ose SikaGrout®-312 HP) tek uji. Përzieni plotësisht për të paktën 3 minuta derisa të përftohet një përzierje homogjene dhe pa kokriza. Në vijim, shtoni gradualisht përbërësin B (SikaGrout® Quartz Sand) dhe përzieni ngadalë edhe për 1-2 minuta akoma derisa të bëhen homogjene. Për rezultate më të mira përzieni thasë të plotë. Mos tejkaloji raportin maksimal të ujit për përzierje.

APLIKIMI

SikaGrout® HT System mund të aplikohet manualisht me teknika tradicionale duke e derdhur brenda zgavrave ose betoformave. Nëse nevojitet, mund të pompohet mekanikisht me pajisje standarde (p.sh. Turbosol, Putzmeister). Për aplikimin grauti me rrjedhje të lirë, është thelbësore të ushtrohet presion hidrostatik tek llaçi. Rekomandohet përdorimi i një hinke me furnizim energjie të vazhdueshëm.

Lagia paraprake:

Sipërfaqet prej betoni duhet të ngopen me ujë të pastër të paktën 2 orë përpara aplikimit, duke siguruar se të gjitha poret dhe gropat janë mjaftueshëm të

lagura. Nuk duhet lejuar tharja e sipërfaqes përpara aplikimit të grautit. Përpara aplikimit, largoni ujin e tepërt dhe sigurohuni se nuk ka ujëra të ndenjtur mbi sipërfaqe. Sipërfaqja duhet të arrijë një paraqitje mat të errët pa shkëlqim dhe poret dhe gropat mbi sipërfaqe nuk duhet të përmbajnë ujë (tharje e ngopur e sipërfaqes (saturated surface dry – SSD)). Përdorni ajër me presion (pa vaj) për të fryrë tutje ujin e tepërt në zonat vështirë për t' u arritur (sidomos pjesa e poshtme e pllakës së bazës dhe betoforma).

Derdhja / Mbushja:

Produkti duhet të hidhet menjëherë mbi nënshtresën mat të errët ose brenda kallëpit të përgatitur për derdhjen. Duke përdorur më shumë se një përzierës dhe me organizimin e duhur, ju mund të derdhni materialin e freskët duke reduktuar fugat e ndërimit. Pas përzierjes së SikaGrout® HT System, lëreni grautin të qëndrojë për ~1-2 minuta; përzieni sërish me një mallë dhe pastaj derdhni menjëherë brenda betoformave të përgatitura të izoluar, të papërkulshme - të fiksuar. Sigurohuni se ajri i bllokuar nga llaçi të mund të dalë lehtësisht, përndryshe do të pengojë kontaktin e plotë të grautit. Për përdorimin sa më të mirë të vetisë përhapëse të grautit, aplikojeni sa më shpejtë të jetë e mundur (brenda max. 15 minutave). Gjithashtu, duhet të merret parasysh edhe koha e punueshmërisë, përshtateni me kushtet klimaterike, kur planifikoni kohëzgjatjen e punimeve. Hidhni grautin brenda betoformës duke lejuar materialin të derdhet deri në fund. Sigurohuni se ruhet presion i vazhdueshëm dhe i mjaftueshëm që të ruhet vazhdimësia e rrjedhjes së grautit që të mos ndalojë përpara përfundimit të punimeve. Sigurohuni që ajri i bllokuar të çlirohet lehtësisht. Mos aplikoni kurrë nga dy vende, pasi do të jetë e vështirë të përcaktohet nëse është çliuar gjithë ajri dhe se është mbushur e gjithë zbrazëtia.

- Kontrolloni gjithmonë materialin pas pompimit
- Sigurohuni se betoforma është mjaft e fortë për të mbajtur llaçin të freskët dhe e izoluar për të parandaluar rrjedhjen
- Trajtoni sipërfaqet e ekspozuara menjëherë me fletë ose membranë mbrojtëse. Mbroni llaçin e freskët nga rrezatimi i drejtpëdrejtë diellor, era dhe ngrirja.
- Përfundoni sipërfaqen e ekspozuar sipas dëshirës sapo llaçi të fillojë të ngurtësohet. Mos hidhni më ujë mbi sipërfaqe.
- Shmangni rënien e lirë të materialit për të parandaluar segregimin e agregateve

Prajmeri / mbrojtësi kundër korrodimit të armaturës:

Mbi një sipërfaqe të mirëpërgatitur dhe ashpërsuar, në përgjithësi nuk nevojitet përdorimi i prajmerit. Kur kërkohet prajmeri dhe/ose një veshje përforcuese (p.sh. Sikadur®-32 EF, Sika MonoTop®- 910 ose SikaTop® Armatec®-110 EpoCem®) referohuni tek skeda teknike përkatëse për informacione më të detajuara. Në çdo rast, prajmeri / mbrojtësi kundër korrodimit të armaturës duhet të aplikohet mbi një nënshtresë paraprakisht të lagur dhe aplikimi në vijim i SikaGrout® HT System duhet të bëhet **i lagësht mbi të lagësht**. Koha e punueshmërisë së prajmerit dhe/ose mbrojtësit kundër korrodimit duhet të merret parasysh nëse plotëson kërkesat e aplikimit.

Shtimi i trashësisë maksimale të shtresës:

Për sasi të mëdha (> 20 lt) ose aplikime në shtresa të

trashë (>50mm), trashësia maksimale e shtuar e shtresës mund të arrihet ose me shtesëzim (mbivendosje shtresash).

Ndërtimi i shtresave:

Shtresa e parë duhet të fortësohet dhe reaksioni ekzotermik i materialit duhet të përfundojë. Shtresa e 1-rë duhet të fillojë të mpikset dhe të jetë në temperaturë mjedisi përpara se të aplikohet shtresa e dytë. Mos e lëmoni shtresën e parë përpara aplikimit të shtresës së dytë. Shtresa e parë duhet të pastrohet me ujë me presion të ulët ose ajër të kompresuar përpara aplikimit të shtresave vijuese të llaçit.

METODA E MATURIMIT

Mbroni llaçin e freskët të aplikuar nga dehidratimi i hershëm dhe/ose tharja e parakoshme duke përdorur metoda të përshtatshme trajtimi (të paktën për 24 orë), p.sh. përbërës trajtimi si Sika® Antisol® ose Sikafloor® Proseal sapo të ketë avulluar uji mbi sipërfaqe. Përdorni mbulesa të përshtatshme trajtimi si jutë dhe ujë, membrana plastike ose të tjera të përshtatshme.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga mjetet dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet duke përdorur ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar/ maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Për punime të mbushjes së pllakave të bazamenteve referohuni tek Sika Method Statement për "Grouting me bazë çimentoje të bazamenteve të makinerive dhe pllakave të bazës" (Ref. 8502101) për më shumë informacione rreth aplikimit, përgatitjes së nënshtresës dhe betoformës, teknikave të derdhjes, etj.

Për punimet e riparimit të betonit referohuni tek Sika Method Statement për "Restaurimin e strukturave të betonit me derdhje duke përdorur llaçet gati për përdorim nga Sika®" (Ref. 8503202) për më shumë informacione rreth aplikimit të sistemit të riparimit, përgatitjes së nënshtresës dhe/ose referohuni tek rekomandimet e dhëna tek EN 1504-10.

KUFIZIME

- Përbërësi B (SikaGrout® Quartz Sand) duhet të përdoret në kombinim vetëm me Përbërësin A (SikaGrout®-212 Classic ose SikaGrout®-312 HP).
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar.
- Mos shtoni çimento apo substanca të tjera që mund të dëmtojnë vetitë e llaçit.
- Mos shtoni ujë ose llaç të freskët në një përzierje që ka filluar të mpikset.
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtëpërdrejtë diellor dhe/ ose erë të fortë.
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresë të qëndrueshme dhe të përgatitur saktë.
- Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrirja dhe shiu.
- Mos hidhni ujë shtesë gjatë finiturës së sipërfaqes, pasi kjo gjë mund të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritje.
- Regjistroni temperaturat e ambientit dhe nënshtresës përpara dhe gjatë aplikimit.
- Përzierja duhet të kryhet gjithmonë me mjete mekanike, përzierja me dorë nuk lejon përfundimin e punueshmërisë së duhur të materialit.
- Në rast shtrimi të dyshemesë, sidomos në mjedis të jashtëm, shmangni tharjen e shpejtë të produktit në ditët e para të maturimit.
- Mos shtroni dysheme në kushte të këqija moti, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë negative procesin e mpiksjes dhe ngurtësimit të produktit.
- Nuk duhet të përdoret si një mbishtresë në zona të pakufizuara.
- Ekspozojini sipërfaqet sa më pak.
- Mos vibroni.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaGrout® HT System

Mars 2019, Botimi 02.01

020201010010000221

SikaGroutHTSystem-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf

BUILDING TRUST

